



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË

NOTER GENTJANA BRATI
ADRESA NJESIA ADMINISTRATIVE
NR.7, RRUGA GJERGJ FISHTA,
GODINA NR.9, AP. NR. 1, HYRJA NR.1
TEL: 0682032619

KONTRATË KONCESIONI

Nr. repertori: 2712

Nr. koleksioni: 941

Tirane më 02/11/2021



Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"

*Akti noterial përbëhet nga 1 fletë



A2021053340101855016



A2021053840101859016

REPUBLIKA E SHQIPERISË
ZYRA E NOTERISË TIRANË

NR. 2712 Rep.

NR. 941 Kol.

KONTRATË SHITESË KONCESIONI

PËR

DISA NDRYSHIME NË KONTRATËN E KONCESIONIT TË FORMËS “BOT”
(NDËRTIM-OPERIM-TRANSFERIM)
PËR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALIT “STRAVAJ” – LIBRAZHD

Në Tiranë, më datë 02, muaji MENTOR, viti 2021 (dymijë e njëzet e një), para meje noter Gi Bnadi, anëtar i dhomës së Noterisë TIRANË, me adresë Dr. Gjergj Fishta Tiranë, u paraqitën palët kontraktuese si më poshtë:

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, përfaqësuar me autorizim të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë Nr. 4226/1, datë 21/10/2021 (kopje bashkëlidhur) nga Z. Ilir Bejtja, i datëlindjes 17/01/1966, madhor dhe me zotësi juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u sigurova nga Letërnjoftimi ID

DHE

Shoqëria “Stravaj Energy” sh.p.k, themeluar si person juridik datë 24.05.2011 dhe regjistruar në QKB datë 23.06.2011, me NUIS L11823001A, e përfaqësuar ligjërisht nga administratori i shoqërisë Z. Ymer Dashi, i datëlindjes 10/02/1955 madhor dhe me zotësi juridike për të vepruar për identitetin e të cilës u sigurova nga Pasaporta me ID Nr.

të cilët me vullnetin e tyre të lirë, bien dakord si më poshtë:

Të lidhin këtë Kontratë Shtesë Koncesioni, si pjesë përbërëse e Kontratës së Koncesionit të formës “BOT” (Ndërtim – Operim – Transferim) për ndërtimin e hidrocentralit “Stravaj”– Librazhd, lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (Autoritet Kontraktues) dhe shoqërisë “Mak-Olimpik” sh.p.k (Koncesionari) me Nr.991 Rep., Nr.177 Kol., datë 05/05/2008, miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.569, datë 07.05.2008.



Hyrje



Hyrje

Duke pasur parasysh që:

- Ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (Autoritet Kontraktues) dhe shoqërisë “Mak-Olimpik” sh.p.k (Koncesionari) është lidhur Kontrata e Koncesionit e formës “BOT” për ndërtimin e hidrocentralit “Stravaj”-Librazhd me Nr. 991 Rep., Nr. 177 Kol., datë 05 Maj 2008, miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 569, datë 07.05.2008, (në vijim referuar si Kontrata e Koncesionit);
- Sipas konkluzionit përfundimtar të Oponencës Teknike, paraqitur nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore me shkresën Nr. 6280/1 Prot., datë 16.04.2012, protokolluar në METE me Nr. 3768 Prot., datë 18.04.2012, Autoriteti Kontraktues me shkresën Nr. 3768/1 Prot., datë 14.05.2012 “Miratohet projekti i zbatimit të HEC-it “Stravaj” drejtuar shoqërisë koncesionare “Stravaj Energy” sh.p.k, ka miratuar projektin e zbatimit të HEC-it “Stravaj”;
- Nga auditimi i kryer nga Kontrolli i Lartë i Shtetit në Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore me objekt: “Mbi përputhshmërinë – Mbikëqyrja e shfrytëzimit të burimeve hidroenergjetike”, janë konstatuar diferenca midis kontratës së koncesionit me Nr. 991 Rep., Nr. 177 Kol., datë 05 Maj 2008 të formës “BOT” për ndërtimin e hidrocentralit “Stravaj”, të lidhur midis METE-s (Autoritet Kontraktues) dhe shoqërisë “Mak-Olimpik” sh.p.k (Koncesionari) dhe projekt zbatimit të vlerësuar pozitivisht nga grupi i Oponencës Teknike dhe të miratuar nga Autoritetit Kontraktues me shkresën Nr. 3768/1 Prot., datë 14.05.2012, lidhur me prodhimin e energjisë elektrike;
- Referuar gjetjeve për këtë kontrate dhe në zbatim të rekomandimeve të KLSH-së, MIE me shkresën Nr. 1780/8 Prot., datë 17.02.2020 “Mbi kontratën shtesë të koncesionit për reflektimin e parametrave hidroenergjetikë” drejtuar shoqërisë koncesionare “Stravaj Energy” sh.p.k ka kërkuar paraqitjen e kësaj të fundit pranë Autoritetit Kontraktues (sot Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë), për nënshkrimin e kontratës shtesë të koncesionit për reflektimin e parametrave hidroenergjetikë në përputhje me projekt zbatimin e vlerësuar nga Oponenca Teknike dhe të miratuar nga Autoriteti Kontraktues.
- Shoqëria koncesionare “Stravaj Energy” sh.p.k me shkresën e datës 20.05.2021 “Përndryshimin e kontratës së koncesionit sipas tuajës Nr.1780/8 Prot datë 17.02.2020”, protokolluar në MIE me Nr. 4226 Prot., datë 20.05.2021 ka konfirmuar gatishmërinë e saj për të lidhur kontratën shtesë të koncesionit;
- Mbështetur në nenin 28 “Ndryshime”..... “Kjo kontratë mund të ndryshohet me marrëveshje të shkruar të dy palëve. Çdo amendim i kësaj kontrate apo anekseve bashkëlidhur saj, do të hyjë në fuqi pasi të miratohet nga Këshilli i Ministrave të...



AL021053840101855016



AL021053840101855016

Republikës së Shqipërisë dhe do të jetë pjesë përbërëse dhe e pandashme e kësaj kontrate".



Në Kontratën e Koncesionit të formës "BOT" (Ndërtim – Operim – Transferim) për ndërtimin e hidrocentralit "Stravaj"- Librazhd, lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (Autoritet Kontraktues) dhe shoqërisë "Mak -Olimpik" sh.p.k (Koncesionari) me Nr. 991 Rep., Nr. 177 Kol., datë 05 Maj 2008, miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 569, datë 07.05.2008, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

Neni 1

Në nenin 1 "Përkufizime dhe interpretime",

Në pikën 1.3 "Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës" zëvendësohet me "Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë",

Në pikën 1.5 shprehja: "...me fuqi të instaluar 3626 (tre mijë e gjashtëqind e njëzet e gjashtë) kW dhe prodhim të energjisë elektrike 16,370,000 kWh (gjishtëmbëdhjetë million e treqind e shtatë dhjetë mijë)", zëvendësohet me shprehjen: "me fuqi të instaluar 3600 kW (tre mijë e gjashtëqind) kW dhe prodhim të energjisë elektrike 16,650,000 (gjashtëmbëdhjetë million e gjashtëqind e pesëdhjetë mijë) kWh, i përbërë nga tërësia e objekteve që shërbejnë për prodhimin e energjisë elektrike duke përfshirë por pa u kufizuar në to: veprën e marrjes, kanalën e devijimit, basenin e presionit, tubacioni që dërgon ujin në turbine, lidhja me sistemin, ndërtesën e centralit së bashku me makineritë dhe pajisjet e instaluar në të".

Neni 2

Neni 3 "Karakteristikat e hidrocentralit Stravaj" ndryshohen si më poshtë:

- | | |
|----------------------------------|--------------------|
| - Kuotat e veprave | |
| o Në degën e Fragonishtës | -864 m |
| o Në degën e Radigozës | -865 m |
| o Në degën e Gjigjiromës | -865 m |
| - Fuqia e Instaluar | 3,600 kW |
| - Prodhimi i energjisë elektrike | 16,650,000 kWh/vit |

Neni 3

Neni 8 "Të drejtat dhe detyrimet", pika 6 ndryshohet si më poshtë:

- Të zbatojë projektin për ndërtimin e HEC-it "Stravaj" me fuqi të vendosur jo më pak se 3600 kW.

Neni 4

Në nenin 23 "Sanksionet", në pikën 23.2 zëvendësohet me shprehjen :

"Në rast mosrealizimi, për faj të koncesionarit të prodhimit të energjisë elektrike prej 16,650,000 kWh, Koncesionari penalizohet me 5% të vlerës së prodhimit të energjisë elektrike të miratuar nga autoritetet për periudhën raportuese".



A20105534010035836



0210534010035836

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

Neni 5

Neni

Kjo Kontratë Shtesë koncesioni hyn në fuqi pas miratimit nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me nenin 28 të kontratës së koncesionit.

Kontrata Shtesë e Koncesionit u hartua në 5 (pesë) kopje dhe pasi iu lexua palëve, të cilët e kuptuan dhe e pranuan atë, e nënshkruan me vullnet të lirë e të plotë dhe unë noteri e vërtetoj atë rregullisht sipas ligjit.

PALET

AUTORITETI KONTRAKTUES

SHOQËRIA KONCESIONARE

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

“Stravaj Energy” Sh.p.k

Përfaqësuar me Autorizim Nr. 4226/1, datë 21/10/2021
të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nga:

Përfaqësuar nga:

Z. Ilir Bejtja

Z. Ymer Dashi

ADMINISTRATOR